

VENDIM
Nr. 333, datë 4.5.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE
TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES
QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas ndarjes “Ministria e Zhvillimit Urban”, shtohet ndarja “Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara”, me përcaktimet e paraqitura në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.

3. Ngarkohet Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Institucioni Buxhetor	Emertesa e Bordit/Keshilli/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Shpërblim kryetari (Lekë)	Shpërblim anëtar (Lekë)
			Kryetari	Nr. i Anëtareve		
Agjencia e Ofrit të Shërbimeve Publike të Integruara	Këshilli Drejtues	8	1	6	20.000	20.000